



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.

PRISHTINA





RAPORTI TM-3 TË KRU “PRISHTINA” Sh.A., PËR VITIN 2025

Vendimi: (1-51)

Bordi i Drejtorëve të KRU “Prishtina” Sh.A., i emëruar me vendimin e Qeverisë nr. 01/81, të datës 01.06.2022 dhe i plotësuar me vendimin nr. 05/186, të datës 24.1.2024, në mbledhjen e pesëdhjetë e një të rregullt të mbajtur me datë 27.11.2025, pas shqyrtimit dhe analizimit paraprak të Raportit TM-3 për vitin 2025, në mënyrë unanime aprovoi Raportin TM-3 për vitin 2025.

Raporti TM-3 të KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2025 do të dorëzohet në NJPMNP në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

	Delegoi	Aprovoi
Emri dhe mbiemri:	Zt. Arsim Fetahu Kryeshef Ekzekutiv	Zt. Bashkim Pllana Kryesues i BD-së
Nënshkrimi:		
Datë:	27.11.2025	27.11.2025





RAPORT TM3 - 2025

KRU "PRISHTINA" Sh.A. – PRISHTINË

PËRMBAJTJA

I.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	2
1.2	Aktivitetet kryesore	2
1.3	Takimet menaxheriale dhe diskutimet e brendshme.....	2
1.4	Disa nga aktivitetet kryesore të realizuara gjatë TM3-2025:	3
1.5	Aktivitetet e përditshme dhe të vazhdueshme të ndërmarrjes	3
II.	DEPARTAMENTI TEKNIK	4
2.2	Prodhimi	4
2.3	Situata e furnizimit	5
2.4	Intervenimet ne rrjet	6
2.5	Aplikime për kushte teknike.....	9
2.6	Aplikime për kyçje të reja	10
2.7	Projektet për zbatim/Investimet Kapitale/Plani i Prokurimit/DPZH	10
2.8	Problemet e evidentuara	12
2.9	Masat e propozuara	12
III.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL	13
3.2	Numri i konsumatorëve	13
3.3	Faturimi -m3	14
3.4	Faturimi - €	16
3.5	Arkëtimi - €	18
3.6	Ankesat/Kërkesat teknike dhe komerciale	20
3.7	Inspektimi dhe Shkyçja	20
3.8	Aktivitetet Kryesore.....	23
3.9	Problemet e evidentuara	23
3.10	Masat e propozuara	24
IV.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	25
4.2	Aktivitetet kryesore	25
4.3	Shpenzimet – TM3-2025	25
4.4	Arsyeshmëria e shpenzimeve	26
4.5	Problemet e evidentuara	26
4.6	Masat e propozuara	26
4.7	Transaksionet kryesore.....	26
V.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	27
5.2	Personeli.....	27
5.3	Përmbaruesit privat.....	27
VI.	AUDITORI I BRENDSHËM.....	28
6.2	Raport mbi aktivitetet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm – TM3/2025	28
VII.	ZYRA E PROKURIMIT	29
7.2	Raporti ka këtë radhitje:	29
7.3	Aktivitetet e iniciuara dhe të pa iniciuara nga plani për TM3_2025	29
7.4	Investimet kapitale dhe inicimi për TM3_2025;.....	29
7.5	Aktivitetet jashtë planit të prokurimit për TM3_2025.....	29
7.6	Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara për TM3_2025	29
VIII.	DEPARTAMENTI I CILËSISË DHE BURIMEVE TË UJIT	32
8.2	Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit raportues	32
8.3	Specifiko disa nga aktivitetet kryesore	32
8.4	Punët e planifikuara në shërbime përkatëse dhe shkalla e realizimit të tyre.....	33
8.5	Shërbimi kualiteti i ujit pijshëm	33
IX.	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	37
9.2	Aktivitete te rregullta sipas detyrave te punës:	37
9.3	Aktivitete te veçanta administrative gjate periudhës se raportimit:	37
9.4	Aktivitete te veçanta teknike gjate periudhës se raportimit:	37
9.5	Veprimet për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA.....	38
9.6	Detyrat dhe sfidat për periudhën ne vijim	38
X.	DEPARTAMENTI I UJIT TË PAFATURUAR	39
XI.	PERFORMANCAT E PËRGJITHSHME	43
11.2	KRU „PRISHTINA“ SH.A – TM3-2025	43
11.3	KRU „PRISHTINA“ SH.A – TM2/2025-TM3/2025.....	44
XII.	PASQYRAT FINANCIARE.....	45
12.2	Bilanci i Gjendjes.....	45
12.3	Pasqyra e të ardhurave	46
XIII.	REALIZIMI I CAQEVE -KRU „PRISHTINA“ SH.A	47
XIV.	ORGANOGRAMI	48

I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina" Sh.A. gjatë periudhës raportuese të tremujorit të tretë të vitit 2025 (korrik–gusht–shtator) ka zhvilluar një sërë aktivitetesh në kuadër të fushe veprimtarisë së saj operative dhe zhvillimore. Këto aktivitete janë zhvilluar në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara që nga viti 2024, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët.

Gjatë kësaj periudhe, ndërmarrja ka arritur të mbajë stabilitetin operativ dhe është fokusuar në përgatitjen dhe zbatimin e masave konkrete për:

- Parandalimin dhe eliminimin e kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjetës;
- Identifikimin e rasteve të keqpërdorimit të ujit të pijshëm nga konsumatorë jolegjitimë;
- Rritjen e kontrollit teknik dhe administrativ mbi konsumin e ujit dhe strukturën e rrjetit.

1.2 Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës raportuese të tremujorit të tretë të vitit 2025 (korrik–gusht–shtator), KRU "Prishtina" Sh.A. ka zhvilluar një sërë aktivitetesh në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj operative dhe zhvillimore. Këto aktivitete kanë qenë në vazhden e objektivave strategjike të përcaktuara që nga viti 2024, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët.

Ndërmarrja ka arritur të mbajë stabilitetin operativ dhe është fokusuar në përgatitjen dhe realizimin e masave konkrete për:

- Parandalimin dhe eliminimin e kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjetës,
- Identifikimin e rasteve të keqpërdorimit të ujit të pijshëm nga konsumatorë jo legjitim,
- Rritjen e kontrollit teknik dhe administrativ mbi konsumin e ujit dhe strukturën e rrjetit.

Këto masa kanë synuar përmirësimin e indikatorëve të performancës dhe rritjen e efikasitetit të ndërmarrjes, si dhe forcimin e transparencës dhe menaxhimit të burimeve ujore.

1.3 Takimet menaxheriale dhe diskutimet e brendshme

Gjatë kësaj periudhe, menaxhmenti i ndërmarrjes ka mbajtur takime të rregullta, ku janë diskutuar çështje prioritare si:

- Performanca mujore në faturim dhe inkasim,
- Gjendja e infrastrukturës së rrjetit të ujësjetës dhe kanalizimit,
- Zonat problematike me qasje të pamjaftueshme në rrjetin publik të ujit,
- Siguria në operime dhe gatishmëria për menaxhimin e emergjencave,
- Planifikimi dhe zbatimi i projekteve kapitale për zgjerim dhe rehabilitim të rrjetit,
- Koordinimi ndër-institucional dhe mundësitë për bashkëpunim dypalësh me partnerë të brendshëm dhe ndërkombëtarë.

1.4 Disa nga aktivitetet kryesore të realizuara gjatë TM3-2025:

- Vizita e Sekretarit të Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Qeverisë Gjermane, z. Johann Saathof, Impiantin e Trajtimit të Ujit në Shkabaj.
- Takim kordinues dhe mobilizues me IKSHKP për shfaqjen e manganit në liqenin e Badovcit.
- Nënshkrimi të marrëveshjeve të kontributit për projektin “Climate Appropriate Urban Development: Sewage Prishtina (incl. Sewage I/II)” për komunën e Prishtinës dhe atë të Fushë Kosovës. Në këtë ceremoni morën pjesë: Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë z. Jörn Rohde, kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina" Arsim Fetahu, kryetari i komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, nënkryetari i komunës së Fushë Kosovës z. Besnik Osmani dhe përfaqësues të lartë të KfW në Prishtinë. Sipas Marrëveshjes Komuna e Prishtinës kontribuan me 11 milion euro (€3,000,000 në vitin 2025, €3,000,000 në vitin 2026, €3,000,000 në vitin 2027 dhe për ndërtimin e 1.2 km të Seksionit Kryesor të Gypit në Kalabri, fillimisht nën përgjegjësi të Komunës, tani do të zbatohet nga projekti – për punët e papërfunduara që do të realizohen nga KRU Prishtina €2,000,000 në vitin 2026), ndërsa Komuna e Fushë Kosovës me 2 milion euro dhe marrëveshja rrjedh si proces i Marrëveshjes së Veçantë e nënshkruar më 7 Dhjetor 2022, ndërmjet KfW, Ministrisë së Ekonomisë dhe KRU Prishtina kërkon nga Agjencia Zbatuese e Projektit të nënshkruajë marrëveshje për kontribute me komunat përkatëse në lidhje me Kontributet e Palës Bashkëpunuese të përcaktuara në Planin e Kostove dhe Financimit.
- Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëfinancim të projektit, ndërmjet KRU “Prishtina”, të përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, z. Arsim Fetahu, dhe Komunës së Drenasit, të përfaqësuar nga Nënkryetari, z. Arben Shala.

Ky memorandum do të mundësojë realizimin e projektit “Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Komunën e Drenasit”, me vlerë totale prej 79,858.00 €.

KRU “Prishtina” do të kontribuojë me 50,000.00 €

Komuna e Drenasit do të financojë me 29,858.00 €

- Takime të rregullta me KfW Development Bank në kuadër të projektit “Appropriate Urban Development: Sewage Prishtina Project (Sewage I & II)” me fokus të veçantë në: Komponentën e zgjerimit të rrjetit të kanalizimit.

1.5 Aktivitetet e përditshme dhe të vazhdueshme të ndërmarrjes

KRU “Prishtina” ka vijuar pandërprerë me ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët, përmes aktiviteteve të rregullta operacionale si:

- Monitorimi 24/7 i cilësisë së ujit të pijshëm, në përputhje me standardet ligjore dhe shëndetësore,
- Raportime të rregullta mbi gjendjen e liqeneve akumuluese Batllava dhe Badovci, për të informuar publikun mbi kapacitetet ujore dhe furnizimin,
- Njoftime teknike për ndërprerjet e planifikuara apo defektet në rrjet, për transparencë dhe planifikim nga konsumatorët,
- Informim për mundësitë e pagesës së shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit përmes kanaleve të ndryshme, për të përmirësuar përfshirjen e konsumatorëve në sistemin e pagesave,
- Njoftime emergjente kur palë të treta shkaktojnë dëmtime në rrjetin e ujësjellësit, që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme,
- Fushata vetëdijësuese për kursimin dhe shfrytëzimin racional të ujit të pijshëm, si dhe mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja dhe keqpërdorimi.

II. DEPARTAMENTI TEKNIK

2.2 Prodhimi

Tabela nr.1 – Korrik- Shtator-2025

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	Total
1	PRISHTINË	3,590,473	3,445,192	3,116,041	10,151,706
2	FUSHË KOSOVË	441,526	441,500	441,524	1,324,550
3	OBILIQ	273,725	263,583	270,335	807,643
4	GRACANICË	175,318	175,310	175,317	525,945
5	SHTIME	112,460	100,570	97,980	311,010
6	LIPJAN	259,155	251,697	228,697	739,549
7	PODUJEVË	390,167	385,369	357,791	1,133,327
8	DRENAS	297,688	279,631	285,280	862,599
9	Gjithsej - KRUP	5,540,512	5,342,852	4,972,965	15,856,329

Koment: Gjatë kësaj periudhe raportuese (TM3-2025), prodhimi i ujit ka paraqitur luhatje të lehta ndërmjet muajve korrik, gusht dhe shtator, duke reflektuar kryesisht dinamikat operative dhe nevojat ditore të sistemit. Prodhimi total ka arritur në 15,856,329 m³, me Kontribute të dallueshme nga Njësitet Operative të Prishtinës dhe Podujevës, të cilat vazhdojnë të kenë sasinë më të lartë të prodhimit në nivel kompanie.

Njësitet si Fushë Kosova dhe Obiliqi paraqesin një trend të qëndrueshëm me ndryshime të vogla mujore, në përgjithësi, prodhimi i periudhës ka mbetur stabil dhe i harmonizuar me kërkesat operative.

Tabela nr. 2 – Prodhimi –TM3-2024/2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	TM3-2025	Dallimi	Dallimi%
1	PRISHTINË	10,020,509	10,151,706	131,197	1.31%
2	FUSHË KOSOVË	1,335,791	1,324,550	-11,241	-0.84%
3	OBILIQ	781,622	807,643	26,021	3.33%
4	GRACANICË	529,522	525,945	-3,577	-0.68%
5	SHTIME	417,790	311,010	-106,780	-25.56%
6	LIPJAN	737,584	739,549	1,965	0.27%
7	PODUJEVË	1,035,004	1,133,327	98,323	9.50%
8	DRENAS	850,614	862,599	11,985	1.41%
9	Gjithsej- KRUP	15,708,436	15,856,329	147,893	0.94%

Koment: Gjatë periudhës TM3-2025, është vërejtur një rritje totale prej 147,853 m³ krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, që përfaqëson një rritje prej 0.94% në nivel të përgjithshëm të prodhimit të ujit. Rritje të theksuar në përqindje kanë shënuar: Podujeva me +9.50%, Obiliqi me +3.33%, Drenasi me +1.41%, Prishtina me +1.31% dhe Lipjani me +0.27% rritje. Ndërsa disa njësi operative si Shtimja (-25.56%), Fushë Kosova (-0.84%) dhe Graçanica (-0.68%) kanë shënuar ulje të lehtë në prodhim.

Diagrami nr. 1. – Prodhimi –TM3-2024/2025





Tabela nr.3 – Realizimi i caqeve- Prodhimi TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2025	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi në %
1	PRISHTINË	10,151,706	9,217,812	933,894	10.13%	110.13%
2	FUSHË KOSOVË	1,324,550	1,589,052	-264,502	-16.65%	83.35%
3	OBILIQ	807,643	833,347	-25,704	-3.08%	96.92%
4	GRACANICË	525,945	446,061	79,884	17.91%	117.91%
5	SHTIME	311,010	335,276	-24,266	-7.24%	92.76%
6	LIPJAN	739,549	728,098	11,451	1.57%	101.57%
7	PODUJEVË	1,133,327	1,111,779	21,548	1.94%	101.94%
8	DRENAS	862,599	823,371	39,228	4.76%	104.76%
9	Gjithsej- KRUP	15,856,329	15,084,796	771,533	5.11%	105.11%

Koment Gjatë kësaj periudhe raportuese TM3-2025 ka arritur **15,856,329 m³**, duke tejkaluar planifikimin prej **15,084,796 m³** me një diferencë prej **771,533 m³**, që përfaqëson **105.11%** realizim ndaj planit. Njësitë operative që kanë realizuar mbi 100% të planit janë **Prishtina (110.13%)**, **Graçanica (123.08%)**, **Shtime (103.10%)**, **Lipjani (113.58%)**, **Podujeva (101.94%)** dhe **Drenasi (104.76%)**, duke treguar performancën mbi objektivat e vendosura. Ndërkaq, **Fushë Kosova (87.16%)**, **Obiliq (97.25%)** dhe **Podujeva (93.15%)** kanë realizim nën planifikim, me devijime të lehta që sugjerojnë kërkesë më të ulët apo stabilizim të konsumit në këto zona.

Diagrami nr. 2. – Realizimi i caqeve- Prodhimi TM3-2025



2.3 Situata e furnizimit

Në tremujorin e tretë të vitit 2025, furnizimi me ujë ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm dhe pa vështirësi të theksuara. Në disa raste, sidomos në zonat e larta, është vërejtur mungesë e ujit të pijshëm për shkak të konsumit të lartë në zonat më të ulëta, veçanërisht gjatë periudhave me kërkesë të lartë gjatë kohës së pikut të verës. Kjo situatë është ndikuar nga kërkesa e lartë për ujë, e cila reflektohet në sasinë e rritur të ujit të trajtuar. Megjithatë, situata e burimeve ujore ka qenë e favorshme duke mundësuar trajtimin e sasisë së mjaftueshme të ujit për të gjithë zonën e shërbimit.

Megjithatë, furnizimi me ujë në zonën e ITUP Badovc është përballur me sfida të mëdha, në pjesën e tretë të kësaj periudhe, si pasojë e prezencës së elementit kimik mangan në ujin e burimit të Liqenit të Badovcit. Këto probleme u shkaktuan nga ndryshimet e temperaturës dhe largimin e efektit të stratifikimit të liqenit, duke bërë që mangani të kalojë në formën e tij dyvalente (Mn^{2+}). Kjo gjendje e ka pamundësuar procesin e fundërrimit të manganit, duke lënë si opsion të vetëm oksidimin e tij.

Bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), janë organizuar autobote për furnizimin me ujë të pijshëm për banorët e zonave që furnizohen nga ITUP Badovc. Njoftimet për këto masa janë bërë publike përmes ueb faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale.

Stafi i Drejtorisë Teknike dhe ITUP Badovc është përballur me një situatë emergjente të menaxhimit, duke zbatuar dozimin e elementeve kimike për trajtim, si dioksidi i klorit (ClO_2) dhe permanganati i kaliumit (KMnO_4), si dhe duke ruajtur dozimin e aluminit sulfat $[\text{Al}_2(\text{SO}_4)_3]$.

Si pasojë, situata është menaxhuar duke siguruar furnizimin vetëm me ujë teknik, ndërsa uji i pijshëm është shpërndarë përmes autoboteve. Sipas Direktivës Evropiane për Ujin, në udhëzim administrativ Nr. 10/2021, prezenca e manganit në ujë nuk lejohet të jetë më e lartë se 0.05 mg/l. Për këtë arsye, IKSHPK ka lëshuar një deklaratë zyrtare, duke rekomanduar që gjatë kësaj periudhe uji të mos konsumohet për pije dhe të përdoret vetëm si ujë teknik për qëllime higjienike personale dhe mjedisore. Mund të thuhet se TM3 2025 ka kaluar pa probleme tjera madhore në trajtimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit. Niveli i dy akumulimeve kryesore, Batllava dhe Badovci, ka qenë i qëndrueshëm, duke garantuar rezerva të mjaftueshme ujore për periudhën raportuese.

Mbetet shqetësim niveli i lartë i turbullirës në kanalin furnizues dhe pamundësia për trajtim të ujit në ITUP Shkabaj gjatë reshjeve. Gjatë pjesës së tretë të tremujorit, janë paraqitur turbullira shtesë si pasojë e punimeve të kryera në kanal nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc", gjë që ka ndikuar negativisht në trajtimin efikas të ujit në ITUP Shkabaj. Kjo situatë nënvizon nevojën për përmirësime të mëtejshme në infrastrukturën e trajtimit të ujit.

2.4 Intervenimet ne rrjet

Tabela nr.4 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej Intervenime
1	PRISHTINË	462	649	20	1,131
2	FUSHË KOSOVË	106	157	0	263
3	OBILIQ	85	75	0	160
4	GRACANICË	140	56	0	196
5	SHTIME	19	34	0	53
6	LIPJAN	144	112	0	256
7	PODUJEVË	219	30	0	249
8	DRENAS	114	21	4	139
9	Gjithsej- KRUP	1,289	1,134	24	2,447

Koment: Gjatë periudhës TM3-2025 janë realizuar gjithsej **2,447 intervenime** në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Pjesa më e madhe e intervenimeve është kryer në **rrjetin e ujësjellësit (1,289 raste)** dhe **rrjetin e kanalizimit (1,134 raste)**, ndërsa **24 raste** i përkasin kategorisë së ndërhyrjeve të tjera.

Sa i përket shpërndarjes sipas njësive operative, **Prishtina** ka numrin më të lartë të intervenimeve (**1,131 raste**), duke pasuar nga **Fushë Kosova (263 raste)**, **Lipjani (256 raste)** dhe **Podujeva (249 raste)**. Kjo tregon intensitet më të madh të mirëmbajtjes në zonat me densitet më të lartë të rrjetit dhe konsumatorëve.

Njësitë me numër më të ulët ndërhyrjesh janë **Shtime (53 raste)** dhe **Drenas (139 raste)**, duke reflektuar stabilitet më të madh të rrjetit në këto zona gjatë periudhës së raportimit.

Tabela nr.5 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2024/2025

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	Korrik	406	408	3	817
2	Gusht	429	357	6	792
3	Shtator	454	369	15	838
4	Gjithsej	1,289	1,134	24	2,447

Koment:

Tabela nr.6 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2024-2025

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet në rrjetin e ujësjellësit	Intervenimet në rrjetin e kanalizimit	Intervenimet të tjera	Gjithsej - Intervenime
1	TM3-2024	1,170	993	37	2,200
2	TM3-2025	1,289	1,134	24	2,447
3	Dallimi	119	141	-13	247
4	Dallimi në %	10.17%	14.20%	-35.14%	11.23%

Koment: Krahasuar me TM3-2024, në vitin 2025 është shënuar një rritje prej 11.23% në numrin e përgjithshëm të ndërhyrjeve. Rritja më e theksuar vërehet në rrjetin e kanalizimit (+14.20%) dhe në rrjetin e ujësjellësit (+10.17%), ndërsa është evidentuar një ulje prej 35.14% në ndërhyrjet e tjera. Kjo rritje mund të interpretohet si rezultat i shtimit të kërkesave për mirëmbajtje dhe ndërhyrje korrigjuese, por njëkohësisht mund të reflektojë rritje të kapaciteteve operationale dhe të reagimit teknik në adresimin e problematikave të rrjetit.

Diagrami nr.3 Intervenimet ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit – TM3-2025




Tabela nr.7 Pastrimi i pushtave te kanalizimit – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Pastrimi i pushtave	Pastrimi i pushtave me shpërlarje	Vendosja e te kapakëve pushtave	Rehabilitimi i rrjetit
1	PRISHTINË	558	2,702	9	1
2	FUSHË KOSOVË	0	330	0	0
3	OBILIQ	0	147	0	0
4	GRACANICË	0	120	0	0
5	SHTIME	6	66	2	1
6	LIPJAN	0	125	0	0
7	PODUJEVË	60	36	0	0
8	DRENAS	210	1,439	2	0
9	Gjithsej- KRUP	834	4,965	13	2

Koment: Gjatë TM3-2025 janë pastruar gjithsej 834 puseta dhe janë kryer 4,965 shpërlarje, me një fokus të lartë në Prishtinë, e cila përfaqëson pjesën më të madhe të aktivitetit. Vendosja e kapakëve dhe rehabilitimi i rrjetit kanë qenë më të kufizuara, duke përfshirë vetëm 13 vendosje kapakësh dhe 9 ndërhyrje rehabilituese. Kjo tregon një fokus më të madh në mirëmbajtjen rutinore dhe zhblokimin e rrjetit.

Tabela nr.8 Pastrimi i pusetave të kanalizimit – TM3-2025

Nr.	Përshkrimi	Pastrimi i pusetave	Pastrimi i pusetave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pusetave	Rehabilitimi i rrjetit
1	Korrik	206	1,412	2	0
2	Gusht	209	1,065	1	0
3	Shtator	183	1,064	8	2
4	Gjithsej	598	3,541	11	2

Koment: Gjatë TM3 të vitit 2025, janë realizuar gjithsej 598 pastrime pusetash dhe 3,541 shpërlarje, me aktivitet më të lartë në gusht (209 pastrime dhe 1,065 shpërlarje) dhe korrik (206 pastrime, 1,412 shpërlarje). Shtatori ka pasur rënie të lehtë me 183 pastrime dhe 1,064 shpërlarje. Në këtë periudhë janë vendosur gjithsej 11 kapakë dhe janë kryer 2 ndërhyrje rehabilitimi. Të dhënat tregojnë një shpërndarje të balancuar të punës gjatë muajve të tremujorit dhe një ritëm të qëndrueshëm mirëmbajtjeje të rrjetit të kanalizimit.

Tabela nr.9 Pastrimi i pusetave të kanalizimit – TM3-2024/2025

Nr.	Përshkrimi	Pastrimi i pusetave	Pastrimi i pusetave me shpërlarje	Vendosja e kapakëve te pusetave	Rehabilitimi i rrjetit
1	TM3-2024	185	3,844	9	1
2	TM3-2025	598	3,541	11	2
3	Dallimi	413	-303	2	1
4	Dallimi në %	223.2%	-7.9%	22.2%	100.0%

Koment: Krahasuar me TM3-2024, në TM3-2025 është shënuar një rritje të konsiderueshme në pastrimin e pusetave, nga 185 në 598, që përfaqëson një rritje prej 223.2%. Numri i shpërlarjeve ka rënë lehtë nga 3,844 në 3,541 (-7.9%), ndërsa vendosja e kapakëve është rritur ndjeshëm nga 4 në 11 (+225%). Rehabilitimet kanë mbetur të qëndrueshme në 2 ndërhyrje. Këto ndryshime tregojnë një intensifikim të mirëmbajtjes rutinore, me theks në pastrimin mekanik të rrjetit dhe përmirësimin e sigorisë përmes vendosjes së kapakëve të rinj.

Diagrami nr.4 - Pastrimi i pusetave të kanalizimit – TM3-2024/2025




Tabela nr.10 Intervenimet në shërbimet elektro makinerike– TM3-2025

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet ne shërbimin e Elektrikes	Intervenimet ne shërbimin e makinerisë	Intervenimet të tjera	Gjithsej Intervenime
1	Korrik	57	42	4	103
2	Gusht	57	32	4	93
3	Shtator	38	44	4	86
4	Gjithsej	152	118	12	282


Koment: Gjatë TM3-2025 janë kryer gjithsej 282 ndërhyrje, me aktivitet më të lartë në korrik (103 ndërhyrje). Kjo shpërndarje tregon një menaxhim efektiv të ndërhyrjeve në funksion të mirëmbajtje dhe stabilitet të infrastrukturës elektro-mekanike.

Tabela nr.11 Intervenimet në shërbimet elektro makinerike– TM3-2024/2025

Nr.	Përshkrimi	Intervenimet ne shërbimin Elektrikes	Intervenimet ne shërbimin e makinerisë	Intervenimet të tjera	Gjithsej Intervenime
1	TM3-2024	163	142	11	316
2	TM3-2025	152	118	12	282
3	Dallimi	-11	-24	1	-34
4	Dallimi në %	-6.7%	-16.9%	9.1%	-10.8%

Koment Krahasuar me TM3-2024, në vitin 2025 ka pasur zvogëlim në -10.8% në totalin e ndërhyrjeve, nga 316 në 282. Kjo zvogëlim i lehtë tregon angazhim të vazhdueshëm për mirëmbajtje dhe stabilitet të infrastrukturës elektro-mekanike.

Diagrami nr.5 Intervenimet Elektro-Makinerike TM3-2024/2025



2.5 Aplikime për kushte teknike

Tabela nr.12 Periudha raportuese:TM3 2025

Nr.	Njësia Operative	Aplikime	Të kryera	Në procedurë
1	PRISHTINË	52	52	0
2	GRACANICË	12	12	0
3	FUSHË KOSOVË	22	22	0
4	PODUJEVË	16	16	0
5	OBILIQ	5	5	0
6	LIPJAN	21	21	0
7	SHTIME	4	4	0
8	DRENAS	9	9	0
9	Gjithsej- KRUP	141	138	0

2.6 Aplikime për kyçje të reja

Tabela nr.13 Periudha raportuese: TM3 2025

Nr.	Njësia Operative	Aplikime	Të kryera	Në procedurë
1	PRISHTINË	27	19	8
2	GRACANICË	15	14	1
3	FUSHË KOSOVË	6	6	0
4	PODUJEVË	12	12	0
5	OBILIQ	0	0	0
6	LIPJAN	37	37	0
7	SHTIME	100	76	24
8	DRENAS	1	1	0
9	Gjithsej- KRUP	198	165	33

2.7 Projektet për zbatim/Investimet Kapitale/Plani i Prokurimit/DPZH

Hartimi i Projekteve për Zbatim të planifikuara në periudhën raportuese të TM3 nga DPZH

Tabela nr.14 Investimet e projekteve me donator- Periudha raportuese: TM3 2025

Nr.	Investimet Kapitale/DPZH/Emërtimi i Projektit	Statuti /Projekti	Projekti në proces
1	Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm për fshatrat Bardh i Madh, Grabovc dhe Mes Bardhi të komunës së Fushë-Kosovës, me një vlerë financiare prej 300,000.00 euro. Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024. Aneksi: Gyp maxhistrat për furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat e Fushë-Kosovës, me një vlerë financiare prej 170,000.00 euro. Marrëveshje për financim e projekteve kapitale ndërmjet: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	99% e punimeve janë përfunduar
2	Rehabilitimi i rrjetit të Kanalizimit në fshatrat e komunës së Shtimes Faza:2 Vlera financiare 294,200.00 euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	90% e punimeve janë përfunduar
3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyqjet individuale në rrjetin e fshatit Kishnicë të komunës së Graçanicës: Vlera financiare 95,000.00euro Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 06.02.2024.	Në zbatim	97% e punimeve janë përfunduar
4	Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KUR "Prishtina" Vlera financiare 275,000.00euro me mjete vetanake 2. Rehabilitim i ujësjellësit Lipjan dhe Graçanicë Llot 1 e kontraktuar 147,227.95€	Në zbatim	Lot 1: 99% e punimeve janë përfunduar,
5	Projekte të ndryshme të bashkëfinancimit me komunat, komunitetin, donatorët. Fokusimi në zgjerimin e rrjetit, zëvendësimi i rrjetave të amortizuara dhe mirëmbajtje dhe operim të njëjtave (rrjeti i ujit dhe ujërave të ndotura) Vlera financiare 144,700.00euro me bashkëfinancim me Komuna Projekti-1:Ndërrimi i rrjetit të Ujësjellësit në Rr: "Knjaz Milosh" Vlera financiare 64,000.00€ Projekti-2: Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në Miradi dhe ndërtimi i rezervuarit në Miradi V=150m ³	Në zbatim	Lot 1: 99% e punimeve janë përfunduar, Lot 2: 99% e punimeve janë përfunduar,

	Vlera financiare 80,700.00€		
6	Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28,29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe Vlera financiare 2,769,873.91 euro Projekti kapital në Fushë Kosovë i financuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Pushtetit dhe Administrimit Lokal 2024-2025	Në zbatim	99% e punimeve janë përfunduar
7	"Rehabilitimi i rrjetit primar të ujësjellësit në lagjen e Medresesë" Vlera e kontratës 338,354.23 euro	Në zbatim	98% e punimeve janë përfunduar
	Rehabilitimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit në fshatin Grabovc (Projekti i Grabovcit) Lot 1, Vlera e projektit: 343,306.00 €. Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 31.01.2025.	Në zbatim	16% e punimeve janë përfunduar
8	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Herticë: Faza I (projekti i Herticës II). Vlera e projektit 239,394.93 €. Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 31.01.2025.	Në zbatim	27% e punimeve janë përfunduar
9	Rehabilitimi dhe ndërrimi i gypave të ujësjellësit në rrugët Afrim Zhitia dhe Ilir Konushevc në Podujevë (projekti Zhitia - Konushevc). Vlera projektit: 92,797.60 €. Marrëveshjes për financimin e projekteve kapitale në mes: ME (NJPMNP) – KRU-P, datë: 31.01.2025.	Në zbatim	53% e punimeve janë përfunduar
10	-Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KUR Prishtina Sh.A. (Prishtinë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Drenas). Projekti 1: Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU Prishtina (Lipjan-Prishtinë) Lot 1, vlera e projektit 112,996.50€ Projekti 2: Ndërrimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për përmirësimin e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit të KRU Prishtina (Fushë Kosovë-Podujevë) Lot 2, vlera e projektit 108,606.00€	Në zbatim	Lot 1: 5% e punimeve janë përfunduar, Lot 2: 38% e punimeve janë përfunduar,
11	-Projekti: Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Orllan, Turiçicë dhe Kalaticë të komunës së Podujevës, vlera e projektit 103,742.13€.	Në zbatim	6% e punimeve janë përfunduar

Tabela nr.15 Investimet e projekteve me donator- Periudha raportuese: TM3 2025

Nr.	Investimet e projekteve me donator	Statuti /Projekti	Projekti në proces
1	Trajtimi i Ujërave të Zeza për Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë – Komponenti i Ndërtimit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza Kontrata për Konsulencën për Implementim: Vlera e kontratës: 3,453,838.80 Euro Sipas marrëveshjeve me MF dhe Thesarit Francez -Kredi	Në proces	Raporti fillestar, studimi i fizibilitetit, kriteri i dizajnit janë përfunduar. Tani jemi në fazën e dizajnit preliminar/konceptual. Raportet të ndikimit mjedisor dhe socio-ekonomik janë në zhvillim e sipër.

2	Trajtimi i ujërave të zeza për Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë – Komponenti i Kolektorit/Rrjetit të Kanalizimit, AMC -Kontrata për Konsulencën për Masat Shoqëruese: Vlera e kontratës: 2,991,390.25 Euro -Kontrata për Konsulencën për Implementim: Vlera e kontratës: 3,741,431.75 Euro Nënshkrimi i Marrëveshjeve MF/ME, KRUP dhe KfW-Grand	Në proces	Masat shoqëruese dhe suport për PIU. Raportet fillestare është dorëzuar. Është hartuar Strategjia për Humbje të Ujit, e cila do të jete në revidim për çdo vit; Avancimi i Planit të Biznesit Janë nënshkruar kontratat për Ujëmatësit Ultrasonik Zonal për një pilot zone, për Automjetin për Detektim të Humbjeve, Është në proces prokurimi i Avancimit të Sistemit të Faturimit dhe mBilling, Është nënshkruar kontrata dhe është në implementim Avancimi i ArcGIS, Prokurimit të Shërbimeve për Dizajnim të Sistemit të SCADAs për sistemin e ujit të Pijshëm. - Raporti fillestar ka përfunduar. Po ashtu dizajni/projekti i detajuar për rehabilitim të rrjetit në Prishtinë dhe Fushë Kosovë ka përfunduar dhe ka filluar procesi i tenderimit për Kontraktorin për rrjetin e ujërave të zeza. Drafti i dizajnit për kolektorët është dorëzuar dhe kontrolluar/komentuar nga KRUP. Ai do të rishikohet sipas komenteve, pastaj do të vazhdohet me finalizim të dizajnit të detajuar të kolektorit.
---	--	-----------	--

Tabela nr.16 - Hartimi i projekteve - Periudha raportuese: TM3 2025

Nr.	Hartimi i projekteve	Statuti /Projekti
1	Projekti për Rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit për lagjen e Boshnjakeve, Hysenaj, Aliu, Marteta, Uka në Batllavë	Të përfunduara
2	Përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të furnizimit me ujë në rrugën “Nuh Kelmendi” (Ramaj)-Obiliq	Të përfunduara
3	Ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat Milloshevë, Lazarevë, Babimoc, si dhe një pjesë të Mazginit, përfshirë edhe bizneset përgjatë rrugës magjistrale.	Të përfunduara
4	Projekti i ndërtimit të Rezervuarit në Shashkoc V=250m ³	Të përfunduara
5	Projekti i ndërtimit të stacionit të ri, gypit kryesor dhe furnizues si dhe ndërimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Trude, Bernicë e Epërme dhe Poshtme dhe Bardhosh	Të përfunduara
6	Projekti i ndërtimit të gypit furnizues nga rezervuari Mirdita III deri te rruga Ndue Perllesh.	Në Proces

2.8 Problemet e evidentuara

Vjetërsia e rrjetit të shpërndarjes dhe rrjetit të ujërave të ndotura, bënë që të ketë ndërhyrje të shpeshta në sistemet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Tubacionet e rrjetit primar, sekondar dhe terciar kryesisht janë nga materiali AC, FeZn, PVC, që janë ndërtuar ndërmjet viteve të ‘60; ‘70; ‘80; Këto material janë zakonisht me diametër të ndryshëm që shkon nga DN15mm-DN250mm dhe të cilat kanë shkallë të lartë të dëmtimit të cilat rrisin çdo ditë humbjet fizike. Për këtë infrastrukturën e lartcekur jetëgjatësia e asetit tani është zero por të cilat edhe tani janë në funksion

2.9 Masat e propozuara

Ndërimi i infrastrukturës së vjetër me të re, një gjatësi është planifikuar për rehabilitim të rrjetit të ujësjellësit edhe këtë vitë në tërë zonën e shërbimit është duke jap prioritet tubacionet me më shumë rrjedhje

III. DEPARTAMENTI KOMERCIAL**3.2 Numri i konsumatorëve**

Tabela nr.17 Numri i konsumatorëve – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2025
1	Prishtinë	106,308	106,397	106,792	106,792
2	Fushë Kosovë	31,231	31,314	31,440	31,440
3	Obiliq	6,493	6,510	6,542	6,542
4	Graçanicë	4,024	4,030	4,039	4,039
5	Shtime	4,124	4,158	4,181	4,181
6	Lipjan	13,475	13,485	13,549	13,549
7	Podujevë	13,393	13,760	13,809	13,809
8	Drenas	6,717	6,782	6,901	6,901
9	Gjithsej- KRUP	185,765	186,436	187,253	187,253

Tabela nr.18 Nr. i konsumatorëve – TM3 2024/2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	TM3-2025	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI - %
1	Prishtinë	102,710	106,792	4,082	3.97%
2	Fushë Kosovë	29,283	31,440	2,157	7.37%
3	Obiliq	6,405	6,542	137	2.14%
4	Graçanicë	3,964	4,039	75	1.89%
5	Shtime	4,048	4,181	133	3.29%
6	Lipjan	13,112	13,549	437	3.33%
7	Podujevë	13,044	13,809	765	5.86%
8	Drenas	6,599	6,901	302	4.58%
9	Gjithsej- KRUP	179,165	187,253	8,088	4.51%


Koment: Numri i konsumatorëve për periudhën e njëjtë TM3 2025 në raport me periudhën TM3 2024, ka pasur trend të rritjes prej 4.51% në total

Tabela nr.19 Realizimi i cagueve- Numri i konsumatorëve – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2025	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi në %
1	Prishtinë	106,792	106,510	282	0.26%	100.26%
2	Fushë Kosovë	31,440	31,286	164	0.52%	100.52%
3	Obiliq	6,542	6,445	97	1.51%	101.51%
4	Graçanicë	4,039	4,151	(112)	-2.70%	97.30%
5	Shtime	4,181	4,182	(1)	-0.02%	99.98%
6	Lipjan	13,549	13,647	(98)	-0.72%	99.28%
7	Podujevë	13,809	13,257	552	4.16%	104.16%
8	Drenas	6,901	6,701	200	2.98%	102.98%
9	Gjithsej- KRUP	187,253	186,179	1,084	0.58%	100.58%

Komenti: Të dhënat në tabelë TM3 2025 pasqyrojnë se realizimi i planifikimit për numrin e konsumatorëve të ri ka arritur 100.58% duke reflektuar trendin në rritje të ndërtimeve dhe zgjerimit të rrjetit të konsumatorëve.

Diagrami nr.6 Realizimi i caqeve- Numri i konsumatorëve – TM3-2025



3.3 Faturimi -m3

Tabela nr.20 Faturimi m3 – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2025
1	Prishtinë	1,445,050	1,368,633	1,347,464	4,161,147
2	Fushë Kosovë	245,722	259,083	270,343	775,148
3	Obiliq	128,164	127,009	129,430	384,603
4	Graçanicë	56,741	51,197	50,466	158,404
5	Shtime	37,327	47,129	38,454	122,910
6	Lipjan	110,099	109,305	96,024	315,428
7	Podujevë	160,366	170,217	164,288	494,871
8	Drenas	78,802	86,855	79,418	245,075
9	Gjithsej- KRUP	2,262,271	2,219,428	2,175,887	6,657,586

Tabela Nr.21 Faturimi m3 – TM3-2024/2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	TM3-2025	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	4,253,624	4,161,147	(92,477)	-2.17%
2	Fushë Kosovë	722,105	775,148	53,043	7.35%
3	Obiliq	353,145	384,603	31,458	8.91%
4	Graçanicë	181,473	158,404	(17,069)	-9.73%
5	Shtime	164,162	122,910	(41,252)	-25.13%
6	Lipjan	358,102	315,428	(42,674)	-11.92%
7	Podujevë	522,193	494,871	(27,322)	-5.23%
8	Drenas	353,340	245,075	(108,265)	-30.64%
9	Gjithsej- KRUP	6,908,144	6,657,586	(244,558)	-3.54%

Koment: Të dhënat tabelore tregojnë një rënie prej -3.54% në faturimin total të ujit në metër kub për periudhën TM3 2025 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Rënia e faturimit në m³ gjatë TM3-2025 ka ardhur si rezultat i disa faktorëve si prodhimi i ujit ka qenë më i lartë, ndërsa shpenzimet reale të konsumatorëve kanë qenë më të ulëta se pritjet. Përveç kësaj, planifikimi i konsumit ka qenë më i lartë se kapacitetet reale, duke u bazuar në numrin e konsumatorëve dhe pritshmëritë për konsum të

rritur nga diaspora, të cilat nuk janë realizuar. Ndikim të madh kanë pasur edhe humbjet e ujit dhe keqpërdorimet, sidomos gjatë verës në zonat rurale për ujitje, të cilat kanë rritur sasinë e ujit të pa faturuar dhe kanë ulur volumin e faturuar.

Diagrami nr.7 Realizimi i caqeve- Numri i konsumatorëve – TM3-2025





Tabela Nr.22 Realizimi i caqeve -Faturimi m3 – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2025	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	4,161,147	4,446,234	(285,087)	-6.41%	93.59%
2	Fushë Kosovë	775,148	783,186	8,038	-1.03%	98.97%
3	Obiliq	384,603	378,634	5,969	1.58%	101.58%
4	Graçanicë	158,404	197,742	(39,338)	-19.89%	80.11%
5	Shtime	122,910	152,982	(30,072)	-19.66%	80.34%
6	Lipjan	315,428	352,614	(37,186)	-10.55%	89.45%
7	Podujevë	494,871	551,751	(56,880)	-10.31%	89.69%
8	Drenas	245,075	393,834	(148,759)	-37.77%	62.23%
9	Gjithsej- KRUP	6,657,586	7,256,977	(599,391)	-8.26%	91.74%

Diagrami nr. 8. - Realizimi i caqeve m3



Koment Të dhënat tregojnë se realizimi i faturimit në TM3-2025 ka pasur rënie prej -8.26%, ku shumica e Njësive Operative nuk e kanë arritur planifikimin. Kjo vërehet sidomos në njësi si Drenasi, Graçanica dhe Shtimja, të cilat kanë përqindjen më të ulët të realizimit. Në total, KRUP ka realizuar 91.74% të planit.

3.4 Faturimi - €

Tabela nr.23 Faturimi € – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2025
1	Prishtinë	971,834	927,355	916,849	2,816,039
2	Fushë Kosovë	178,230	181,071	187,503	546,803
3	Obiliq	85,203	83,844	85,442	254,490
4	Graçanicë	36,710	33,115	33,415	103,240
5	Shtime	25,022	30,123	25,700	80,844
6	Lipjan	77,449	77,279	69,560	224,288
7	Podujevë	106,221	108,657	105,469	320,347
8	Drenas	49,571	54,546	51,271	155,387
9	Gjithsej- KRUP	1,530,240	1,495,990	1,475,208	4,501,438

Tabela nr.24 Faturimi €, Realizimi i caqeve – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2025	Planifikimi TM3 2025	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,816,039	2,986,592	(170,553)	-5.71%	94.29%
2	Fushë Kosovë	546,803	541,337	5,466	1.01%	101.01%
3	Obiliq	254,490	250,442	4,048	1.62%	101.62%
4	Graçanicë	103,240	130,059	(26,819)	-20.62%	79.38%
5	Shtime	80,844	105,576	(24,732)	-23.43%	76.57%
6	Lipjan	224,288	249,542	(25,254)	-10.12%	89.88%
7	Podujevë	320,347	342,659	(22,312)	-6.51%	93.49%
8	Drenas	155,387	238,406	(83,019)	-34.82%	65.18%
9	Gjithsej- KRUP	4,501,438	4,844,613	(343,175)	-7.08%	92.92%

Koment: Analiza e faturimit në m³ për TM3-2025 tregon një realizim të përgjithshëm prej 92.92% ndaj planifikimit. Njësite si Fushë Kosova dhe Obiliqi kanë realizuar mbi 100% të planit ndërsa njësit si Shtime, Graçanicë, Lipjan dhe sidomos Drenas, për shkak të realizimit shumë më të ulët krahasuar me planin, kanë ndikuar negativisht në totalin e të hyrave bazë faturimit.

Diagrami nr. 9. - Realizimi i caqeve €





Tabela nr.25 Faturimi në € -Realizimi i caqeve pas zbritjes në faturim nga përmirësimet për periudhën TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2025	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,737,051	2,986,592	(249,541)	-8.36%	91.64%
2	Fushë Kosovë	542,063	541,337	726	0.13%	100.13%
3	Obiliq	245,196	250,442	(5,246)	-2.09%	97.91%
4	Graçanicë	102,887	130,059	27,172)	-20.89%	79.11%
5	Shtime	79,734	105,576	25,842)	-24.48%	75.52%
6	Lipjan	223,666	249,542	25,876)	-10.37%	89.63%
7	Podujevë	317,528	342,659	25,131)	-7.33%	92.67%
8	Drenas	149,749	238,406	(88,657)	-37.19%	62.81%
9	Gjithsej- KRUP	4,397,874	4,844,613	(446,739)	-9.22%	90.78%

Diagrami nr. 10 - Realizimi i caqeve për faturim € pas përmirësimeve TM3-2025




Koment: Diagrami dhe tabela paraqesin realizimin e faturimit në TM3-2025 pas zbritjes së borxheve. Nga realizimi fillestar prej 92.92%, ky tregues bie në 90.78% për shkak të stornimeve dhe korrigjimeve të bëra nga gabimet në faturim, në bazë të vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve në KRUP, si dhe të udhëzimeve të ARRU-së. Këto korrigjime kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e vlerës finale të faturimit në euro për periudhën TM3-2025.

Tabela nr.26 Faturimi € pas zbritjes në faturim nga përmirësimet, krahasimi TM3-2024/2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	TM3-2025	Dallimi	Realizimi-në %
1	Prishtinë	2,683,713	2,737,051	53,338	1.99%
2	Fushë Kosovë	460,525	542,063	81,538	17.71%
3	Obiliq	228,542	245,196	16,654	7.29%
4	Graçanicë	106,379	102,887	(3,492)	-3.28%
5	Shtime	95,883	79,734	16,149)	-16.84%
6	Lipjan	225,517	223,666	(1,851)	-0.82%
7	Podujevë	316,432	317,528	1,096	0.35%
8	Drenas	200,788	149,749	(51,039)	-25.42%
9	Gjithsej- KRUP	4,317,779	4,397,874	80,095	1.86%

Diagrami 11-Faturimi € pas zbritjes në faturim nga përmirësimet, krahasimi TM3-2024/2025



Koment: Nga të dhënat e faturimit në euro (€) pas zbritjeve për përmirësime dhe korrigjime, krahasimi TM3-2024/2025 tregon se disa Njësi Operative kanë pasur rritje pozitive, përfshirë Prishtinën (+1.99%), Fushë Kosovën (+17.71%), Obiliqin (+7.29%) dhe Podujevën (+0.35%), të cilat kanë tejkaluar rezultatet e vitit paraprak. Në anën tjetër, disa NJOU kanë shënuar rënie, me theks të veçantë Drenasin (-25.42%) dhe Shtimen (-16.84%), ndërsa Graçanica ka një rënie më të lehtë prej -3.28%. Në total, KRUP shënon një rritje të lehtë prej 1.86%, duke reflektuar një performancë të përmirësuar në raport me TM3-2024.

3.5 Arkëtimi - €


Tabela Nr.27 Arkëtimi € – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2025
1	Prishtinë	994,533	1,127,657	935,273	3,057,463
2	Fushë Kosovë	200,972	208,457	186,351	595,780
3	Obiliq	60,733	100,927	92,192	253,852
4	Graçanicë	40,987	36,929	40,438	118,354
5	Shtime	29,169	37,352	25,582	92,103
6	Lipjan	77,753	89,164	74,788	241,705
7	Podujevë	103,561	124,529	102,873	330,963
8	Drenas	50,646	62,034	43,438	156,118
9	Gjithsej- KRUP	1,558,354	1,787,049	1,500,935	4,846,338

Tabela Nr. 28 Arkëtimi € – TM3-2024/2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2024	TM3-2025	Dallimi	Dallimi në %
1	Prishtinë	2,998,700	3,057,463	58,763	1.96%
2	Fushë Kosovë	579,024	595,780	16,756	2.89%
3	Obiliq	220,199	253,852	33,653	15.28%
4	Graçanicë	138,392	118,354	(20,038)	-14.48%
5	Shtime	113,221	92,103	(21,118)	-18.65%
6	Lipjan	253,571	241,705	(11,866)	-4.68%
7	Podujevë	349,086	330,963	(18,123)	-5.19%
8	Drenas	178,016	156,118	(21,898)	-12.30%
9	Gjithsej- KRUP	4,830,209	4,846,338	16,129	0.33%

Diagrami nr. 12. – TM3 2024/ 2025




Koment: Gjatë TM3–2025 është shënuar një rritje shumë e lehtë të arkëtimit në nivel të ndërmarrjes prej 0.33%, krahasuar me TM3–2024, që paraqet një rritje totale prej 16,129 €. Rritja më e theksuar vërehet në Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Obiliq, të cilat kanë kontribuar pozitivisht në rezultatin e përgjithshëm. Ndërkohë, disa njësi si Graçanica, Shtime, Lipjan, Podujevë dhe Drenas kanë shënuar rënie të arkëtimit, me Drenasin dhe Shtimen që paraqesin uljen më të theksuar. Megjithatë, performanca e përgjithshme mbetet stabile, me trend minimal pozitiv në nivel të KRUP.

Tabela nr.29 Realizimi i caqeve – Arkëtimi € – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	TM3-2025	Planifikimi TM3-2025	Dallimi	Dallimi në %	Realizimi-në %
1	Prishtinë	3,057,463	2,931,281	126,182	4.30%	104.30%
2	Fushë Kosovë	595,780	529,743	66,037	12.47%	112.47%
3	Obiliq	253,852	245,350	8,502	3.47%	103.47%
4	Graçanicë	118,354	127,376	(9,022)	-7.08%	92.92%
5	Shtime	92,103	103,573	(11,470)	-11.07%	88.93%
6	Lipjan	241,705	244,474	(2,769)	-1.13%	98.87%
7	Podujevë	330,963	335,326	(4,363)	-1.30%	98.70%
8	Drenas	156,118	233,457	(77,339)	-33.13%	66.87%
9	Gjithsej- KRUP	4,846,338	4,750,580	95,758	2.02%	102.02%

Diagrami nr. 13.- Realizimi i caqeve -Arkëtimi-TM3 -2025



Koment: Të dhënat e TM3–2025 tregojnë se arkëtimi ka tejkaluar planifikimin në nivel të përgjithshëm, duke arritur 102.02% të caqeve. Kontributin kryesor pozitiv e kanë dhënë Prishtina, Fushë Kosova dhe Obiliqi, të cilat kanë realizuar mbi 100% të objektivave. Në anën tjetër, disa njësi operative si Graçanica, Shtime, Lipjan, Podujevë dhe sidomos Drenasi kanë mbetur nën plan, me devijimin më të lartë negativ (-33.13%). Pavarësisht diferencave ndërmjet njërive, rezultati total i KRUP tregon një performancë të mirë në arkëtim për periudhën TM3–2025.

3.6 Ankesat/Kërkesat teknike dhe komerciale

Tabela nr.30 Ankesat /kërkesat teknike dhe komerciale të shqyrtuara nga komisioni TM3-2025

NR	Njësia Operative	Ankesat teknike	Ankesat komerciale	Kërkesë Teknike	Kërkesë komerciale
1	Prishtinë	0	44	44	582
2	F. Kosovë	1	18	22	125
3	Obiliq	1	3	9	67
4	Graçanicë	2	0	10	34
5	Shtime	0	2	0	14
6	Lipjan	1	4	8	53
7	Podujevë	0	2	3	111
8	Drenas	0	1	9	20
9	Gjithsej-KRUP	5	74	105	1,006

Koment: Në krahasim me llojin e pranimit të kërkesave dhe ankesave në të gjitha NJOU-të, numri më i madh i pranimit të lëndëve janë **kërkesa** teknike 105 dhe komerciale 1,006 ndërsa numri më i ulët janë lëndët e **ankesave** teknike dhe komerciale.

Tabela nr.31 Ankesat /kërkesat teknike dhe komerciale të shqyrtuara nga komisioni TM3-2024/2025

NR	Njësia Operative	Ankesat teknike	Ankesat komerciale	Kërkesë Teknike	Kërkesë komerciale
1	TM3 2024	5	378	299	3,900
2	TM3 2025	10	254	357	3,374
3	Diferenca 25/24	5	-124	58	-526
4	Difer-%	100%	-33%	19%	-13%

Koment: Gjatë tremujorit të tret të vitit 2025 (TM3 2025), është vërejtur një rritje në ankesat dhe kërkesat teknike ndërsa ankesat dhe kërkesat komerciale ka rënie të numrit të pranimit nga konsumatorët. Te ankesat komerciale kemi rënie -33% ndërsa te kërkesat komerciale janë -13% rënie.

3.7 Inspektimi dhe Shkyçja


Tabela nr.32 Inspektimi dhe shkyçja TM3-2025

Nr.	Përshkrimi	Korrik	Gusht	Shtator	TM3-2025
1	Inspektime	1,469	1,610	1,186	4,265
2	Vizita për borxhe	3,339	3,800	3,743	10,882
3	Shkyçjet për borxhe	101	133	91	325
5	Kyçje ilegale	230	83	26	339
6	Raste të dërguara në gjykatë	42	23	3	68
7	Nr. i pagesave nga konsumatorët	1,306	2,677	1,476	5,459
8	Totali i pagesave pas inspekti.	288,462	319,548	280,174	888,184

Tabela nr.33 Inspektimi dhe shkyçja TM3-2024/2025

Nr.	Përshkrimi	TM3-2024	TM3-2025	Dallimi	Dallimi në %
1	Inspektime	2,667	4,265	1,598	59.92%
2	Vizita për borxhe	11,135	10,882	(253)	-2.27%
3	Shkyçjet për borxhe	330	325	(5)	-1.52%
4	Kyçje ilegale	124	339	215	173.39%
5	Raste të dërguara në gjykatë	18	68	50	277.78%
6	Nr. I pagesave nga konsumatorët	4,771	5,459	688	14.42%
7	Totali I pagesave pas inspektimeve	849,300	888,184	38,884	4.58%

Diagrami nr. 14.- Inspektimet-TM3-2024/2025



Koment: Gjatë TM3–2025 vërehet një intensifikim i ndjeshëm i aktiviteteve operacionale në terren krahasuar me TM3–2024. Inspektimet janë rritur me 59.92%, ndërsa rastet e kyçjeve ilegale kanë shënuar rritje shumë të theksuar prej 173.39%, duke reflektuar fokus të shtuar në zbulimin dhe trajtimin e abuzimeve. Edhe rastet e dërguara në gjykatë janë rritur ndjeshëm (+277.78%), si rezultat i identifikimit më të madh të shkeljeve me bazë ligjore. Ndërkohe, vizitat për borxhe dhe shkyçjet për borxhe kanë mbetur pothuajse në të njëjtin nivel, me një rënie të lehtë prej -2.27% dhe -1.52%. Numri i pagesave është rritur me 14.42%, ndërsa vlera totale e arkëtimeve pas inspektimeve është rritur me 4.58%, duke treguar për efektivitet më të madh të veprimeve në terren.

Rritja e numrit të shkeljeve të konstatuara ka çuar në më shumë shkyçje dhe më shumë raste të adresuara në procedura administrative dhe gjyqësore. Në rastet ku nuk plotësohen kushtet për kallëzim penal (mosidentifikimi i konsumatorit, paraqitja për legalizim brenda afatit, apo kyçje e regjistruar por jo e legalizuar), ndërmerret vetëm shkyçja e lidhjes ilegale. Procedurat penale aplikohen vetëm kur ekzistojnë të gjitha elementet ligjore të veprës.

Tabela nr.34 Aktivitet për identifikimin , shkyçje, legalizim dhe arkëtim të borxheve sipas planit të biznesit 2025

Nr.	Përshkrimi	Të planifikuara sipas PB	TM3-2025	Dallimi	Dallimi në %
1	Inspektime	2,667	4,265	1,598	59.92%
2	Vizita për borxhe	11,135	10,882	(253)	-2.27%
3	Shkyçjet për borxhe	330	325	(5)	-1.52%
4	Kyçje ilegale	124	339	215	173.39%
5	Raste të dërguara në gjykatë	18	68	50	277.78%
6	Nr. I pagesave nga konsumatorët	4,771	5,459	688	14.42%
7	Totali I pagesave pas inspektimeve	849,300	888,184	38,884	4.58%

Koment: Gjatë TM3–2025 është vërejtur tejkalim i planifikimeve në shumicën e indikatorëve kryesorë të aktivitetit. Inspektimet janë realizuar 59.92% mbi plan, ndërsa është rritur dukshëm edhe identifikimi i kyçjeve ilegale me një tejkalim prej 173.39%. Po ashtu, rastet e dërguara në gjykatë kanë shënuar rritje

të theksuar prej 277.78%, si rezultat i intensifikimit të masave për mbledhjen e borxheve. Edhe numri i pagesave nga konsumatorët ka tejkaluar planin me 14.42%, duke reflektuar përmirësim në efikasitetin e arkëtimit. Janë ndërmarrë masa të shtuara në terren dhe administrim, përfshirë dërgimin e rasteve në gjykatë, kontaktet sistematike përmes qendrës së thirrjeve dhe shpërndarjen e vërejtjeve. Si rezultat i këtyre veprimeve, totali i pagesave pas inspektimeve ka arritur në 888,184 €, duke tejkaluar planin për 38,884 € ose 4.58%. Vlen të përmendet se janë ri programuar edhe 507,350.69 € borxhe të papaguara për periudhën Korrik -Shtator 2025.


Tabela nr.35 Ndërrimi i ujëmatësve – TM3-2025

Nr.	Prishtinë	Shtëpiak	Komercial	Institucional	Gjithsej
1	Prishtinë	680	77	14	771
2	Fushë Kosovë	82	13	1	96
3	Obiliq	79	2	1	82
4	Graçanicë	22	3	1	26
5	Shtime	91	7	2	100
6	Lipjan	43	5	2	50
7	Podujevë	106	9	0	115
8	Drenas	111	9	1	121
9	Gjithsej- KRUP	1,214	125	22	1,361

Tabela nr.36 Ndërrimi i ujëmatësve – TM3-2024/2025

Nr.	Periudha	Shtëpiak	Komercial	Institucional	Gjithsej
1	TM3-2024	743	118	4	865
2	TM3-2025	1,214	125	22	1,361
3	Dallimi	471	7	18	496
4	Dallimi në %	63%	6%	450%	57%

Diagrami nr.15 - Ndërrimi i ujëmatësve – TM3-2024/2025




Koment: Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, vërehet një rritje e ndjeshme në numrin e ndërhyrjeve me ujëmatës gjatë tremujorit të tret të vitit 2025 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 në të gjitha kategoritë shtëpiak, komercial dhe institucional, është shënuar një rritje si rezultat i inspektimeve të ujëmatësve nga lexuesit, inspektorëve dhe kërkesave të konsumatorëve.

Tabela nr.37 Konsumatorë me dhe pa ujë matës TM3 2025

Nr.	Periudha	Nr. I Konsumator në total	Konsumator me ujëmatës	Konsumator pa ujëmatës
1	TM3-2024	179,165	178,693	-472
2	TM3-2025	187,253	187,056	-197
3	Dallimi	8,088	8,363	275
4	Dallimi në %	4.51%	4.68%	-58.26%

Diagrami nr.16 Konsumatorët pa ujëmatës -TM3-2024/2025



Koment: Të dhënat tregojnë një progres të dukshëm në pajisjen e konsumatorëve me ujëmatës. Numri i konsumatorëve me ujëmatës është rritur nga 178,693 në TM1–2024 në 187,056 në TM3–2025, ndërsa numri i konsumatorëve pa ujëmatës është ulur nga 472 në 197, duke shënuar një rënie prej rreth 58%. Megjithatë, sfida mbetet pajisja e të gjithë konsumatorëve për shkak të kushteve teknike të identifikuara në terren. Kjo tregon një përparim të qartë drejt mbulimit të plotë me ujëmatës dhe përmirësimin e menaxhimit të konsumit të ujit.

3.8 Aktivitetet Kryesore

Drejtoria Komerciale realizon të gjitha kompetencat dhe autorizimet në zonën e shërbimit përmes Departamentit Komercial, Departamentit për Marrëdhënie me Konsumatorët, Departamentit të Kontrollit dhe Lidhjes, si dhe të gjitha NJOU-të.

Gjatë kësaj periudhe TM3 2025, përveç aktiviteteve të zakonshme, janë realizuar aktivitetet kryesore të Drejtorisë Komerciale:

- Është realizuar koordinim dhe komunikim i rregullt me NJOU-të dhe menaxherët për përmbushjen e objektivave të shërbimit.
- Janë mbajtur takime dhe trajnime me Konsulencën, me pjesëmarrjen e menaxherëve të njësive.
- Është bërë leximi dhe faturimi nga lexuesit, përfshirë dokumentimin me foto dhe komente.
- Janë zhvilluar takime me institucione për arkëtimin e borxheve dhe barazimin e faturave të vjetra.
- Janë shpërndarë vërejtje për konsumatorët, përfshirë paralajmërime për shkyçje.
- Janë përgatitur listat për shkyçjen e konsumatorëve me borxhe të papaguara.
- Janë kryer aksione për inspektimin dhe identifikimin e kyçjeve ilegale dhe mbledhjen e borxheve.
- Qendra e Thirrjeve ka trajtuar kërkesa të konsumatorëve dhe ka komunikuar për pagesat.
- Është kryer kontroll i vazhdueshëm i lexuesve në terren për saktësinë e të dhënave në ujëmatës.
- Janë ofruar shërbime përmes aplikacionit mobil, përfshirë dokumentim me foto-komente.

3.9 Problemet e evidentuara

Gjatë periudhës Korrik-Shtator (TM3), janë evidentuar disa probleme që kanë penguar arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit. Problemet kryesore që janë hasur janë si më poshtë:

- Mungesa e ujëmatësve ku zëvendësimi i një numri më të madhë të ujëmatësve pritet të realizohet pas përfundimit të projektit për furnizimin dhe montimin e ujëmatësve i cili ende nuk është realizuar me procedurat e prokurimit.
- Numri i lartë i faturimit të konsumatorëve me 0 si fenomen i banesave boshë. Sipas të dhënave të ASK rreth 30 % e banesave dhe shtëpive në komunën e Prishtinës janë të pabanuara. Mungesa

e banorëve aktivë janë në pronësi të konsumatorëve në diasporë e që nuk shpenzojnë duke rezultuar me konsum me vlerën 0.

- Vështirësi në leximin e ujëmatësve në terrenet e NJOU-ve-jo ka ende lexime të parregullta të ujëmatësve në disa zona, duke shkaktuar pasaktësi në faturim
- Ka pasur vështirësi të lexohen matësit në objekte që kanë dyer të mbyllura, si në rastet e konsumatorëve individual (nuk gjenden në objektet e banimit)
- Gjatë inspektimeve, janë zbuluar parregullsi në faturim, përfshirë mbi-faturimin, nën-faturimin dhe konsumatorët që nuk kanë marrë fare fatura.
- Aprovimi i ankesave nga ARRU dhe kërkesat për fshirje të borxhit-Ankesat nga ARRU dhe kërkesat për fshirje të borxhit për shkak të mos leximit të rregullt të matësve janë aprovuar sipas rregullores.

3.10 Masat e propozuara

Drejtoria Komerciale ka analizuar performancën gjatë kësaj periudhe dhe ka identifikuar disa pengesa në arritjen e objektivave. Për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar performancën, janë planifikuar masat e mëposhtme:

- Vazhdimi i kontrolleve dhe inspektimeve në terren për lexuesit për të siguruar që faturimi bazuar në leximin e matësve reflekton konsumimin faktik të ujit.
- Eliminimi i gabimeve në faturim duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhshme me konsumimin e faktuar.
- Inspektimi i konsumatorëve me 0 faturim duke u siguruar që të mblidhen të dhëna të sakta për konsumatorët që jetojnë jashtë vendit dhe banesat që janë bosh dhe nuk kanë shpenzim.
- Inspektimi i konsumatorëve që nuk gjenden për të verifikuar statusin e tyre .
- Përditësimi i bazës së të dhënave dhe saktësimi i informacionit për të siguruar një proces të saktë dhe të shpejtë faturimi.
- Komunikimi dhe takime të rregullta me NJOU-të për të adresuar dhe eliminuar pengesat operative që mund të ndikojnë në përmbushjen e objektivave do të vazhdojnë.
- Filtrimi dhe kontaktimi i konsumatorëve debitorë nga Qendra e Thirrjeve për pagesën e borxheve dhe për t'i inkurajuar të mbajnë angazhimin për pagesa të rregullta.
- Në vazhdimësi analizë e konsumatorëve me vonesa në pagesa. Do të bëhet një analizë e konsumatorëve që kanë vonesa në pagesa gjatë 12 muajve të fundit, me qëllim parandalimin e parashkrimit të borxheve dhe për të marrë masa para se borxhet të parashkruhen.
- Dërgimi i vërejtjeve për konsumatorët me borxhe të papaguara, për të nxitur pagesat e faturave dhe për të parandaluar shtimin e borxheve të papaguara.
- Mirëmbajtja e programit Mobile Offline-IT-ja dhe kompania kontraktuese do të sigurojnë mirëmbajtjen e vazhdueshme të programit Mobile Offline për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe pa ndërprerje të tij

IV. DEPARTAMENTI I FINANCAVE**4.2 Aktivitetet kryesore**

Në përputhje me obligimet rrjedhëse janë bërë të gjitha veprimet e domosdoshme operative lidhur me trajtimin e çdo dokumenti financiar.

Departamenti është kujdesur për çështjet si në vijim:

- Pagesa e shpenzimeve rrjedhëse
- Kontabilizimi i të gjitha shpenzimeve të operimit dhe investimeve
- Regjistrimi analitik i aseteve
- Komunikimi i vazhdueshëm me auditorët e NJAB gjatë nënshtrimit të proceseve audituese
- Mirëmbajtja e regjistrimeve, pranimi dhe dorëzimi i stokeve përmes depos.
- Shkarkimi i pagesave të konsumatorëve të paguara nga kanalet online
- Operacionet ditore nëpër arkat
- Pagesa e TVSH- së dhe tatimeve tjera

Përgatitja e Pasqyrave vjetore financiare dhe raporteve mujore te ndryshme.

4.3 Shpenzimet – TM3-2025

Tabela nr.38- Realizimi i cageve - Shpenzimet operative

Nr.	Shpenzimet	TM3-2025	Planifikimi	Dallimi	Dallimi në %
1	Shpenzimet e blerjes së ujit me shumicë	227,927	243,150	-15,223	-6.26%
2	Shërbime ndaj ARRU, MMPH, SHUKOS, Oda Eko. etj	57,430	61,921	-4,491	-7.25%
3	Shpenzimet e materialit-kemikalje dhe reagen	21,220	141,040	-119,820	-84.95%
4	Shpenzimet e energjise elektrike	1,474,460	677,795	796,665	117.54%
5	Shpenzimet e karburanteve-lendë djegëse	37,764	33,407	4,357	13.04%
6	Shpenzimet e personelit-paga dhe meditje	2,091,971	2,128,432	-36,461	-1.71%
7	Shpenzimet e materialit dhe materieve të kon	116,386	68,474	47,912	69.97%
8	Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	293,588	143,237	150,351	104.97%
9	Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimit	40,356	35,503	4,853	13.67%
10	Te dalurat financiare -rekreacion-nd.solidar	2,666	2,225	441	19.82%
11	Totali	4,363,768	3,535,184	828,584	

Tabela nr.39 Realizimi i cageve - Shpenzimet operative – TM3-2025

MUAJI	TM3-2024	TM3-2025	NDRYSHIMI €	NDRYSHIMI %
Shpenzimet	231,380	227,927	-3,453	-1.49%
Uji i blerë me shumicë	80,771	57,430	-23,341	-28.90%
Taksat	8,792	21,220	12,428	141.36%
Materialit-kemikalje dhe reagen	643,497	1,474,460	830,963	129.13%
Energjia elektrike	46,850	37,764	-9,086	-19.39%
Karburanti-lendë djegëse	1,802,459	2,091,971	289,512	16.06%
Paga dhe meditje	57,763	116,386	58,623	101.49%
Materialit dhe materieve të kon	222,169	293,588	71,419	32.15%
Shërbimet e kontraktuara	53,817	40,356	-13,461	-25.01%
Mirëmbajtja dhe riparimit	2,480	2,666	186	7.50%
Rekreacion-nd.solidar	3,149,978	4,363,768	1,213,790	

4.4 Arsyeshmëria e shpenzimeve

Gjatë periudhës TM3 në total kemi pasur nivel thuajse të njëjtë me planifikimin për këtë periudhë të TM-3 në nivel total të kategorive. Megjithatë përbrenda kategorive kemi pasur diferenca të cilat do t'i elaborojmë më poshtë:

Më poshtë po i shtjellojmë dallimet kryesore:

- Shpenzimet e energjisë elektrike ishin më të larta si rezultat i daljes në treg të hapur të energjisë elektrike.
- Shpenzimet e kemikaljeve ishin dukshëm më të ulëta se sa planifikimi si rezultat i çmimit më të ulët se sa në kohën kur ishin planifikuar por edhe për shkak se pjesa e materialit është marr nga fabrikat më herët dhe blerja e tyre bëhet sipas nevojës, jo çdo muaj!
- Shpenzimet e pagave ishin më të ulëta për shkak se ende nuk janë përfunduar të gjitha rekrutimet.

4.5 Problemet e evidentuara

Si problem të identifikuar mundemi ta konsiderojmë diferencën tek kategoria e shpenzimeve të kontraktuara si dhe të energjisë elektrike të cilat kishin diferenca me planifikim

4.6 Masat e propozuara

Sa i përket shpenzimeve të energjisë elektrike tashmë veq është bërë planifikimi dhe kërkesa për rritje të buxhetit tek kjo kategori. Kurse sa i përket shpenzimeve të kontraktuara, pagesa e transfereve bankare për muajt paraprak e kanë rritur diferencën në këtë kategori.

4.7 Transaksionet kryesore

Tabela nr.40 Shpenzimet/transaksionet TM3-2025

Nr.	SHPENZIMET/TRANSAKSIONET TM3-2025	VLERA NË - €
1	Keds	1,078,749.52
2	Iber lepec	240,940.41
3	King Shpk	183,397.10
4	LindArt Shpk	102,207.50
5	Posta e Kosoves	92,311.42
6	3D Pro Con	88,148.48
7	Tora Com Shpk	73,072.75
8	Lord Group Shpk	65,946.85
9	X Shpk	61,815.00
10	Scardian	56,028.42

Tabela nr.41 Inkasimet kryesore

Nr.	INKASIMET KRYESORE TM3-2025	VLERA NË - €
1	QKUK-ja	261,357
2	Qendra e Studenteve	35,979
3	Ministr.e Puneve te Mbrendshme	31,418
4	Film Siti Kfori-Artberi	27,521
5	K.Komunal Prishtinë	21,336
6	T.C.Kosova A	20,549
7	Termokosi	18,882
8	FSK-Kazerna Adem Jashari	12,989
9	Burgu i Sigurise se larte Dyz	9,636
10	Federata e Futbollit	4,050

V. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS**5.2 Personeli**

Tabela nr.42 Personeli – TM3-2025

Nr.	Njësia Operative	Korrik	Gusht	Shtator
1	Prishtinë	493	490	490
2	Fushë Kosovë	37	37	37
3	Obiliq	16	16	16
4	Graçanicë	14	14	14
5	Shtime	19	19	19
6	Lipjan	52	52	52
7	Podujevë	31	32	31
8	Drenas	29	29	29
9	Gjithsej- KRUP	691	689	688

5.3 Përmbaruesit privat

Tabela nr.43 Raport i përmbarueseve privat për periudhën TM 3-2025:

NR	Njësia Operative	Rastet e inicuar	Shuma e borxhit	Rastet zgjidhura	Shuma arkëtuar nga lendet TM3
1	Prishtinë	194	86,473.58 €	17	5,840.14 €
2	Fushë Kosovë	40	14,968.60 €	2	467.00 €
3	Obiliq	23	7,108.01 €	1	370 €
4	Graçanicë	5	4,490.01 €	/	/
5	Shtime	13	4,633.04 €	3	371.00 €
6	Lipjan	21	6,098.08 €		/
7	Podujevë	82	28,320.56 €	5	1,139.18 €
8	Drenas	32	15,960.55 €	11	303.19 €
9	Gjithsej- KRUP	410	168,052.43 €	39	8,490.51€

Koment: Totali i arkëtimit ne periudhën TM-3 është: **263,225.78€**

Shuma e ri programimit te borxhit është: **22,080.69€**

Shuma e arkëtuar nga Kallëzimet Penale përmes procedurës se Ndërmjetësimit është: **5,901.63€**

VI. AUDITORI I BRENDSHËM**6.2 Raport mbi aktivitetet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm – TM3/2025**

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar aktivitetet në vijim:

1. Kemi raportuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese (NJQH), për 6 mujorin e parë;
2. Kemi finalizuar 2 auditime sipas planit vjetor të auditimit : Auditimi i Investimeve Kapitale dhe Auditimi i Auto-Parkut;
3. Kemi finalizuar 3 auditimet me kërkesë – Situacionet e dyta për 3 projektet e financuara nga ME (Podujeve, Herticë dhe Graboc);
4. Është mbajtur mbledhja e radhës (mbledhja e 32-të) me Komisionin e Auditimit, ku janë shqyrtuar:
 - Raporti i NjAB: Auditimi i llogarive të arketueshme dhe procesit të faturimit/shitjeve, nr.03/2025;
 - Raporti i ZKA-së për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të KRU “Prishtina” Sh.A., për vitin 2024 dhe plani i veprimit për zbatim të rekomandimeve; dhe
 - Shqyrtimi i rishikimit të Planit të Biznesit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025;
5. Është mbajtur mbledhja e radhës (mbledhja e 33-të) me Komisionin e Auditimit, ku janë shqyrtuar dhe aprovuar:
 - Raporti i auditimit: Auditimi i investimeve kapitale në KRU “Prishtina” Sh.A.
 - Raporti i auditimit: Auditimi i projektit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Herticë - Faza I (Projekt i Herticës II), situacioni i parë
 - Raporti i auditimit: Auditimi i projektit “Rehabilitimi dhe ndërtimi i gypave të ujësjellësit në rrugët “Afrim Zhitia” dhe “Ilir Konushevc” në Podujevë Lot 3, situacioni i parë
 - Raporti i auditimit: Auditimi i projektit “Rehabilitimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit në fshatin Graboc (Projekti i Grabocit), situacioni i parë.
6. Kemi dhënë Këshillën e NjAB – 01/2025, lidhur me orarin e punës me ndërrime;
7. Kemi zhvilluar procedurat e konkursit të jashtëm për rekrutimin e 2 auditorëve – në proces;
8. Kemi përgatitur Draft Raportin për Auditimin e Auto – Parkut - në proces;
9. Kemi marrë pjesë në trajnimin një ditë nga NJQH: Kuptimi dhe zbatimi i Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm (SGAB)
10. Kemi filluar auditimin e radhës – Auditimi i prodhimit/humbjeve – në proces;

VII. ZYRA E PROKURIMIT

Raporti mbulon periudhën TM3 të vitit 2025 dhe jep detaje rreth gjendjes së aktiviteteve të prokurimit, me theks të veçant në kërkesat e planifikuara, ato të iniciuara, të pa iniciuara, investimet kapitale, aktivitetet jashtë planit të prokurimit si dhe kontratat e nënshkruara, për periudhën në fjalë.

7.2 Raporti ka këtë radhitje:

- Aktivitetet e iniciuara dhe të pa iniciuara nga plani për TM3_2025;
- Investimet kapitale dhe inicimi për TM3_2025;
- Aktivitetet jashtë planit të prokurimit për TM3_2025; dhe
- Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara për TM3_2025

7.3 Aktivitetet e iniciuara dhe të pa iniciuara nga plani për TM3_2025

Gjatë kësaj periudhe, kemi planifikuar të inicojmë 6 aktivitete, në vlerë të parashikuar financiare prej 1,011,555 euro, nga të cilat janë inicuar 2 aktivitet, në vlerë financiare prej 504,056 euro (49 %), ndërsa kanë mbetur pa u inicuar 4 aktivitete në vlerë financiare prej 507,499 euro (51%).

7.4 Investimet kapitale dhe inicimi për TM3_2025;

Gjatë kësaj periudhe, në emër të investimeve kapitale, janë planifikuar të inicohen 5 aktivitete, në vlerë të parashikuar financiare prej 500,000 euro dhe deri në fund të TM3, janë inicuar 2 aktivitete, në vlerë financiare prej 430,000 euro (86%).

Gjate këtij tremujort/TM3, jane inicuar edhe 2 aktivitete per rehabilitim te ujësjellësve ne Skullan e Ribarm përkatësisht Fshatin Pjetërshticë.

7.5 Aktivitetet jashtë planit të prokurimit për TM3_2025

Gjatë kësaj periudhe, kemi inicuar 12 aktivitete jashtë planit, numër ky mjaft i lartë, krahasuar me periudhat apo vitet e kaluara. Vlera e parashikuar e ketyre aktiviteteve është 945,418 euro.

7.6 Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara për TM3_2025

Në periudhën raportuese, kemi nënshkruar 20 kontrata, në vlerë financiare prej 1,090,090 euro .

Tabela 44. Aktivitetet e iniciuara dhe të pa iniciuara nga plani për TM3_2025

Nr	Përshkrimi i Kontratës	Afati për inicim	Inicuar Po/Jo	Vlera e parashikuar	Gjendja
1	Furnizimi me cisterna speciale(autobote) për ujë të pijes dhe ujëra të ndotura për kryerjen e shërbimeve në zonën e KRUP_Lot 1 Furnizimi me mjete udhëtimi- vetura për stafin e mbikëqyrjes Lot 2	08.08.2025	Po	430,000	E realizuar pjesërisht
2	Pajisje për dozim të klorit të gaztë dhe pjesë rezervë.	08.08.2025	Jo	50,000	E painicuar
3	Furnizimi me material elektrik	10.09.2025	Po	74,056	Ne proces
4	Furnizimi me reagjentë dhe aparature matëse Kontratë kornize 3 vjeçare	10.09.2025	Jo	392,499	E painicuar
5	Zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ujit-hapja e puseve nëntokësore në tërë zonën e KRU "Prishtina" Sh.A_Lot 1 (10,000 €), Përcaktimi i zonave mbrojtëse - Ngritja dhe mirëmbajtja e burimeve ujore_Lot 2 (10,000 €)	08.08.2025	Jo	20,000	E painicuar
6	Ndërtimi i një objekti shtesë për laborator dhe administratë ITU Badoc	10.07.2025	Jo	45,000	E painicuar

			Gjithsej	1,011,555	
--	--	--	-----------------	------------------	--

Tabela 45. Investimet kapitale dhe inicimi për TM3_2025

Nr.	Përshkrimi	Afati i paraparë	Vlera e parashikuar	Inicimi	Gjendja
1	Zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ujit-hapja e puseve nëntokësore në tërë zonën e KRU "Prishtina" Sh.A.Lot 1	08.08.2025	10,000	Jo	E painicuar
2	Përcaktimi i zonave mbrojtëse - Ngritja dhe mirëmbajtja e burimeve ujore Lot 2	08.08.2025	10,000	Jo	E painicuar
3	Furnizimi me cisterna speciale (autobote) për ujë të pijes dhe ujëra të ndotura për kryerjen e shërbimeve në zonën e KRUP	08.08.2025	280,000	Po	Ne proces
4	Furnizimi me mjete udhëtimi- vetura për stafin e mbikëqyrjes	08.08.2025	150,000	Po	Ne proces
5	Pajisje për dozim të klorit të gaztë dhe pjesë rezervë.	08.08.2025	50,000	Jo	E painicuar
		Gjithsej	500,000		

Investimet kapitale dhe inicimi për TM3_2025	Sipas numrit	%	Sipas vlerës	%
Investimet kapitale të planifikuara TM3	5	100	500,000	100
Investime kapitale të inicuar TM3	<u>2</u>	<u>40</u>	<u>430,000</u>	<u>86</u>
<i>Investime kapitale të realizuara</i>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>
<i>Investime kapitale në proces</i>	<u>2</u>	<u>40</u>	<u>430,000</u>	<u>86</u>
<i>Investime kapitale të dështuara</i>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>
Investimet kapitale të painicuar TM3	3	60	70,000	14

Tabela 46. Investime kapitale pas rishikimit të Planit të Biznesit për vitin 2025

Nr.	Përshkrimi i projekteve	Vlera e parashikuar	Periudha për inicim	Inicuar Po/Jo	Statusi
1	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fsh.Skullan (lot 1) dhe Ribar i Vogël (lot 2)Lipjan; Lagjen e Boshnjakeve-Hysenaj- Aliu në Batllavce (lot 3)	355,000	-	Po	Ne procesin e vlerësimit
2	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fsh. Pjetershtice	520,000	-	Po	Hapja më 16.10.2025
	Gjithsej investime kapitale pas rishikimit të PB për v.2025	875,000			

Tabela 47. Aktivitetet jashtë planit të prokurimit për TM3_2025

Nr.	Përshkrimi	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës	Gjendja
1	Punë shtese Ndërrimi dhe ndertimi I rrjetit për furnizim me ujë në Graçanicë, nr.70433736-24-5892-5-2-1	6,779		Ne proces
2	Punë shtese Instalimi i pajisjes për dozim të klorit,nr.70433736-24-10579-1-2-1	1,150		Ne proces
3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fsh.Skullan (lot 1) dhe Ribar i Vogël (lot 2)Lipjan; Lagjen e Boshnjakeve-Hysenaj- Aliu në Batllavce (lot 3)	355,000		Ne proces
4	Punë shtese për Miradi Uglare_Miradi e Uglare 70433736-24-10528-5-2-1-Lindart	10,555		Ne proces

5	Pune shtese për Bardh i Madh Grabovc e Mesbardh 70433736-24-3103-5-2-1-Lindart	6,300	6,295	E realizuar
6	Furnizim me trafo-stacion 50 kW-10 (20) KV	9,996		Ne proces
7	Ndërtimi I linjes shtese për ne SP - 10 KV	9,111		Ne proces
8	Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellësit ne fsh. Pjetershtice	520,000		Ne proces
9	Furnizim me material mbushes-zhavor V=700 m3	9,999		Ne proces
10	Rimbështjella e elektromotoreve	950	920	E realizuar
11	Punë shtesë Rhebilitimi dhe ndërtimi I gypave te ujësjellësit ne rrugen Afrim Zhitija dhe Ilir Konushevci 70433736-25-1983-5-1-1	8,920		Ne proces
12	Pune shtese Rehabilitimi I rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Babush I Muhaxhereve Lot 2	6,658		Ne proces
Gjithsejt		945,418		

Tabela 48. Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara për TM3 2025

Nr.	Përshkrimi	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratave	Operatori Ekonomik
1	Furnizimi rehabilitimi dhe ngritja- avancimi i sistemit-teknologjisë së trajtimit të ujit nëpër IT- UP (Transformator, inventar, pajisje makinerike, elektronike): Furnizim dhe montimi i transformatorit 35 04kv për Albanik, dhe shtrirja e kabullit 10 24kv dhe kyçja ne trafostacinin e KED-sit ne Mazgit për furnizim te stacionit te pompave Millosheve Lot 1 (Rregullimi i SCAD-es ne ITU Badoc nuk është inicuar)	60,000	44,206	RISAMONT SH.P.K.
2	Furnizimi dhe montimi i valvulës njëkahore hidraulike me kundërpeshë Lot 3	7,000	4,425	Ejona SH.P.K.
3	Lot 1.Mirëmbajtja e automjeteve të rënda dhe transportuese (120,000 euro)	120,000	120,000	Ramadan Raçi B.I.
4	Funksionalizimi i cisternave te Drenasit dhe Podujevës Lot 1 (7,000 euro), Furnizimi me mjete të punë për operim dhe mirëmbajtjen e automjeteve Lot 2 (50,000 euro)	57,000	39,556	Comet SH.P.K
5	Furnizim me Ujë të Xhamave, Lubrifikante, Vajra të motorit, Vajra të tjera sipas destinimit,antifriz 100 % , antifriz G12,	13,350	9,676	Ballkan Petrol
6	Furnizimi me harduer (kompjuter, lap-top e monitorë) lot 1	76,650	75,720	Future BITS SHPK
7	Furnizimi me pajisje dhe montim për dhomën e Serverave dhe rrjetin kompjuterik Lot2	30,000	25,936	Future BITS SHPK
8	Zhvillim i modulit call center , hardueri i nevojshëm dhe ndërlidhje me Billing dhe mirëmbajtje 1 vjeçare e sistemeve të implementuara Lot3	40,000	21,970	CMD
9	Pajisje për leximin dhe printimin në teren te faturave Lot 4	25,000	19,930	Cactus SH.A.

10	Furnizim me antracit (për shtimin në filtra për shkak të kohës së gjatë të ekzistimit) ne ITU Badoc dhe ITU Shkabaj	13,600	33,136	Profitech SHPK
11	DDD_Kontrate kornize 3 vjeçare	30,000	13,200	Ekologjia SHPK
12	Kalibrimi i pajisjeve matëse laboratorike_Kontrate kornize 3 vjeçare_Lot 1	10,000	9,999	Flamur Isufi B.I
13	Marrja me qira e bombolave të Acetilenit, heliumit dhe azotit_Lot 2	2,500	2,500	MESSER MEDICA L.L.C
14	Lot 2. Klor gaztë dhe atestim i kontejnerëve 1000kg dhe bombolave 150 kg dhe klor kg 240000 dhe Hipoklorur natriumi kg 90000	476,000	403,200	Seykos SH.P.K
15	Lot 5.Polielektrolit anjonik	25,000	18,900	CMC Group
16	Mirëmbajtje dhe zhvillime Sistemit të faturimit masiv Billing_Lot 1, Mirëmbajtje e licencave ERP Financa, Dynamics Navision_Lot 2	40,000	39,920	Asseco SEE
17	Rehabilitimi dhe ndërrimi i gypit kryesor në rrugën Brigadat në Podujevë (Projekti Bigadat-100K Lot 4) Ritender;	100,000	93,508	Lindart & Arbotec shpk
18	Projekte të ndryshme të bashkëfinancimit me komunitetin, komunitetin, donatorët. Fokusimi në zgjerimin e rrjetit, zëvendësimi i rrjetave të amortizuara. Mirëmbajtje dhe operim të njëjtave (rrjeti i ujit dhe ujërave të ndotura)	83,000	75,383	K-ing SHPK
19	Kontroll, servisim, mbushje dhe furnizim i aparateve kundër zjarrit dhe hidrantëve të murit	9,900	4,929	ALBKOS SAFETY
20	Marrja e printerva me qira KK 3 vjeçare	36,000	33,996	ASTRONIK SH.P.K.
Gjithsej		1,255,000	1,090,090	

VIII. DEPARTAMENTI I CILËSISË DHE BURIMEVE TË UJIT

8.2 Aktivitetet apo përshkrimi i shkurtër i punëve të kryera brenda muajit raportues

Sipas planit tremujor TM3 për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në KRU"Prishtina" sh.a, të burimeve sipërfaqësore Albanik,Badocv, Bivolak,Mihaliq (Kanali Ibër-Lepencit) si dhe burimeve nëntokësore Kroni, Obiliq, Shtimje ,Lipjan, Peran (Podujevë), Miradi , Graçanicë dhe Vragoli si dhe pesëmbëdhjetë pikat në rrjetin e qytetit , në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues kemi përcjellë kualitetin e ujit të pijshëm në çdo pikë mostrimi.

Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ Nr.10/2021 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.

8.3 Specifiko disa nga aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit korrik-shtator TM3 2025, Departamenti i Cilësisë së ujit përveç monitorimit bazik operacional dhe kontrollë të cilësisë së ujit pijshëm është marrë me shumë aktivitete tjera shtesë si

